



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal
Mbledhja nr.55/2019
Prishtinë, më 22.01.2019, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Sala Berisha Shala, kryetare, Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Glauk Konjufca, Liburn Aliu, Hykmete Bajrami, Lutfi Zharku, Memli Krasniqi, Muharrem Nitaj, Veton Berisha dhe Duda Balje, anëtarë.

Mungoi: Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, anëtar.

Pjesëmarrës: Ardian Syla dhe Naser Peci – Bordi i Trepçës; Shyqyri Sadiku – Sindikata e Trepçës; Liridon Gashi – SEEF; Vatra Qehaja dhe Blerim Sallahu – LVV; Dren Ajeti – Klubi i prodhuesve; Blerta Bejtullahu – ZVSK/EU Office; si dhe mediat.

Stafi mbështetës i komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti dhe Veton Raci.

Mbledhjen e kryesoi: Sala Berisha Shala, kryetare e komisionit.

Rendi i ditës:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 27 dhe 28.12.2018;**
3. **Shqyrtimi Projekt-Statutit i Trepça SH.A.;**
4. **Shqyrtimi i Raportit të Panelit për zgjedhjen e Bordit të NP KOSTT SH. A.;**
5. **Të ndryshme.**

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

Kryetarja i uroi anëtarëve të komisionit dhe të pranishmëve të tjerë një vit të ri të mbarë, me unitet dhe bashkëpunim më të madh në të mirë të qytetarëve të Kosovës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 27 dhe 28.12.2018

Procesverbalet, e mbledhjeve të mbajtura më 27 dhe 28.12.2018, u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi Projekt-Statutit i Trepça SH.A.

Kryetarja potencoi se në tetor të vitit 2016 u miratua Ligji për Trepçën, dhe kemi menduar se me miratimin e këtij ligji do të bëhet funksionalizimi i këtij gjiganti industrial. Askush nuk ka menduar se funksionalizimi i Trepçës do të vonohet aq gjatë. Në maj 2018 Qeveria e Kosovës, përkatësisht Bordi i Trepçës e ka dërguar Projektstatutin e Trepçës në Kuvend. Në ndërkohë janë paraqitur pakënaqësitë e sindikatës së Trepçës, me të cilët edhe kemi mbajtur takim. Jemi dakorduar që çështjet sociale të cilat janë shqetësim serioz i minatorëve të Trepçës të trajtohen me një ligj të veçantë, për arsye se në shoqëritë aksionare nuk lejohet që në statutin e tyre të kenë edhe çështje sociale. Po ashtu minatorët e Trepçës kanë pasur pakënaqësitë e tyre se disa asete kanë mbetur të pa përfshira si asete të Trepçës. Ne kemi marrë dokumentet përcjellëse nga sindikata se cilat kanë qenë ato asete të Trepçës, që konsiderojmë se janë thelbësore për funksionalizimin e Trepçës. Qeveria e Kosovës, bordi i Trepçës dhe sindikata e Trepçës, pas takimeve të përbashkëta, kanë arritur marrëveshje për çështjet e ngritura nga sindikata. Ne i kemi përfshirë të gjitha ato çështje që kanë dalë nga ajo marrëveshje dhe tash në këtë dokument me tri kolona e kemi projektstatutin e ardhur nga bordi në kolonën e parë, propozimet e sindikatës në kolonën e dytë dhe projektstatuti me propozimet e inkuorporuara në kolonën e tretë. Ajo ftoi përfaqësuesin e bordit të Trepçës, z. Naser Peci të sqarojë më hollësisht projektstatutin me ndryshimet e inkuorporuara.

Naser Peci, Bordi i Trepçës, theksoi se statuti i Trepçës është një nga pikat e ligjit për Trepçën. Pas krijimit të bordit vijnë hapat e tjerë për zbatimin e ligjit. Ne në Qershor të vitit të kaluar e kemi dërguar statutin në Kuvend. Në ndërkohë sindikata ka shprehur disa pakënaqësi. Kemi mbajtur takime pune të përbashkëta me sindikatën dhe Qeverinë dhe kemi arritur marrëveshje për përmbajtjen e projektstatutit.

Liburn Aliu theksoi se të gjithë jemi dakord se është jashtëzakonisht e rëndësishme që të ketë statut të saj Trepça, dhe të gjithë kemi qenë bashkë në tërë procedurën e gjatë të procesit të miratimit të statutit. Në statutin që na ka ardhur tash është i njëjti, por iu është bashkangjitur një dokument i cili paraqet marrëveshjen mes të Qeverisë dhe të sindikatës. Po ashtu jemi dakord që këto asete të jenë pjesë e statutit. Mirëpo mendojmë që rruga edhe më e shpejtë edhe më efikase është që bordi bashkë me Qeverinë t'i inkuorporojnë këto vërejtje në statut dhe mos t'ia lejnë këtë punë Komisionit dhe Kuvendit. Nëse ne, si Kuvend, e marrim përsipër me ri përpiluar statutin vihemi në kundërshtim së pari me ligjin dhe e dyta mund të bëjmë gabime. Tash ne a me krijuar grup punues, me propozuar amendamente, me dërguar në lexim të parë, mandej në lexim të dytë, proceduralisht nuk është e shkruar askund, ose ne vetë të marrim përpilimin e një

statut të ri me këto propozime dhe me ia paraqitur seancës! Çka nëse propozimet tona nuk votohen në seancë? Bordi duhet me e sjell një statut, të cilin e miraton Kuvendi. Bordi le t'i inkorporojë propozimet në statut, le ta sjellë në Kuvend dhe ne e miratojmë.

Hykmete Bajrami theksoi se kemi pasur takime për projektstatutin edhe në vitin 2018, dhe në këto takime e kam ngritur shqetësimin tim se si Kuvend nuk kemi të drejtë ta ndryshojmë projektstatutin. Ne nuk e kemi marrëveshjen mes sindikatës dhe Qeverisë. Ne po e shohim gjendjen dhe jemi të gatshëm pas tri ditëve të mblidhemi dhe ta miratojmë. Jemi kundër që ne të bëjmë ndryshime në statut. Projektstatuti të vije i kompletuar nga bordi dhe ne e miratojmë.

Dardan Sejdiu potencoi se nuk kemi nevojë të ngutemi dhe të veprojmë me hapa të gabuar. Projektstatuti të na vijë nga bordi si i kompletuar. Nëse Qeveria, bordi dhe sindikata mblidhen edhe e sjellin projektstatutin e kompletuar, ne sot e votojmë. Vetëm të na sillen nga bordi projektstatuti i dakorduar dhe të jetë i qartë.

Muharrem Nitaj pyeti përfaqësuesit e bordit të Trepçës: Pse bordi nuk e ka hartuar projektstatutin final? Nëse keni marrëveshje me sindikatën dhe Qeverinë atëherë pse nuk e keni inkorporuar në projektstatut dhe të na sillni projektstatutin të kompletuar? Ai kërkoi të shtyhet miratimi i projektstatutit për mbledhjen e radhës.

Memli Krasniqi theksoi ka shumë muaj që na ka mbete në dorë ky projektstatut. Pasi ka ardhur në Kuvend ky projektstatut kanë dalë disa mospajtime nga sindikata. Mirë kishte me qenë që bordi me e sjell versionin final të projektstatutit. Mendoj që edhe procedura duhet të respektohet.

Kryetarja sqaroi se Qeveria nuk ka kërkuar me tërheq projektstatutin për me inkorporuar propozimet, por ka kërkuar që ne t'i inkorporojmë propozimet.

Naser Peci, Bordi i Trepçës, theksoi se tash kjo doli si çështje procedurale. Ne kemi menduar se paraqitja e projektstatutit me tri kolona do të bëjë më të qartë ndryshimet në projektstatut. Statuti sigurisht që është derivat i ligjit. Statuti është dokument themelues i Trepça SH.A. Kolona e tretë e paraqitur në dokumentin e projektstatutit është shumë e afërt me marrëveshjen e arritur.

Shyqyri Sadiku, sindikata e Trepçës, theksoi se është dashur që bordi me e ngritur çështjen e aseteve. Fajtorë për këtë vonesë të projektstatutit është bordi. Bordi nuk ka dashtë me i përfshirë vërejtjet tona. Duhet të dëgjohet edhe zëri i aksionarit të dytë që është zëri i punëtorëve.

Pas diskutimeve, komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

Bordi i Trepçës të tërheq projektstatutin ekzistues dhe të sjellë në Kuvend projektstatutin me propozimet e inkorporuara sipas marrëveshjes me Qeverinë dhe sindikatën.

4. Shqyrtimi i Raportit të Panelit për zgjedhjen e Bordit të NP KOSTT SH. A.

Kryetarja theksoi se ky komision me përkushtim e ka filluar punën më 14 janar ku kemi filluar me intervistimin e kandidatëve për anëtarë të bordit të KOSTT-it. Më tutje kryetarja pasqyroi procesin që nga shpallja e konkursit për anëtarë të bordit të KOSTT-it deri në përzgjedhjen e kandidatëve për t'i propozuar për seancë plenare. Ajo shtoi se në bazë të nenit 14 të Ligjit nr. 05/L-085 për energji elektrike, Ministria e Administratës publike shpall konkursin për drejtor të bordit të KOSTT-it, dhe dosjen e aplikantëve ia dorëzon Kuvendit të Kosovës. Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, si komision përkatës për energji, më datë 3.10.2018, mori vendim për formimin e Panelit për zgjedhjen e anëtareve të Bordit, në këtë përbërje: Sala Berisha -Shala; Adem Hoxha dhe Hykmete Bajrami. Ky panel shqyrtoj aplikacionet dhe formoj listën e ngushtë për kandidatët të cilët kishin plotësuar kushtet sipas ligjit. Më datë 22.11.2018, komisioni zgjeroi Panelin Përzgjedhës, për të zhvilluar procedurat e rekrutimit, në këtë përbërje si vijon: Sala Berisha- Shala (GP PDK) dhe kryesuese, Adem Hoxha (GPLS), Hykmete Bajrami (GPLDK), Liburn Aliu (GPLVV), Muharrem Nitaj (GPAAK), Veton Berisha (GPNISMA) dhe Duda Balje (GP6+), ndërsa vullnetarisht është tërhequr përfaqësuesi i grupit parlamentar PSD. Sipas rekomandimit të Projekti „BDO” i angazhuar nga Ambasada Britanike në Kosovë për monitorimin e rekrutimeve në pozita të larta drejtuese në institucionet publike, Paneli Përzgjedhës duhet të jetë më një numër më të vogël të anëtareve dhe të jenë konstant gjatë procesit të intervistimit, përfundimisht Paneli Përzgjedhës kishte këtë përbërje si vijon: Sala Berisha- Shala (GP PDK) dhe kryesuese, Hykmete Bajrami (GPLDK), Liburn Aliu (GPLVV) dhe Veton Berisha (GPNISMA). Në konkurs kanë aplikuar 33 (tridhjetë e tre) kandidatë, ndërsa, bazuar në kriteret formalo ligjore, Paneli Përzgjedhës ka përzgjedhur 29 (njëzetë e nëntë) kandidatë, duke themeluar listën e ngushtë dhe të njëjtit u ftuan në intervistë. Ndërkaq, vullnetarisht, 6 (gjashtë) kandidatë janë tërhequr nga gara. Nga data 14 deri më 18 janar 2019, Paneli Përzgjedhës, zhvilloj procesin e intervistimit të kandidatëve të ftuar dhe prezent – 23 (njëzet e tre), ku pas zhvillimit të procesit të intervistimit dhe të poentimit bazuar në performancën e tyre, vendosi t'i propozojë Kuvendit 12 (dymbëdhjetë) kandidatët më me së shumti poena, sipas kërkesës ligjore që së paku për një pozitë të propozohen dy kandidatë. Ajo kërkoi që këtë listë me këta 12 kandidatë të procedohet për seancë plenare.

Dardan Sejdiu pyeti: a përputhet poentimi i Panelit me poentimin e BDO-së?

Kryetarja sqaroi se sipas përvojave të BDO-së ata kanë shprehur një falënderim dhe kanë thënë që është hera e parë që jemi shumë të përafërt me poentimin e Panelit.

Muharrem Nitaj theksoi se puna e Panelit intervistues dhe kërkesat e BDO-së për dinamikën e punës të Panelit intervistues ka qenë në shpërputhje me mundësitë e anëtarëve të Panelit intervistues, meqenëse është kërkuar për pesë ditë radhazi të punohet nga ora tetë e mëngjesit deri në ora tetë e mbrëmjes. Unë që në ditën e parë e kam ngritur shqetësimin që një gjë e tillë është e pamundur edhe për shkak të obligimeve që mund të kenë anëtarët e Panelit intervistues dhe besoj që herëve të tjera duhet të koordinohemi më mirë dhe të mos ndodhë që një panel prej shtatë anëtarëve, për shkaqe objektive, në fund të rezultojë me katër anëtarë.

Kryetarja sqaroi se ka qenë shumë e vështirë me një dinamikë tërë ditën, ashtu e kanë projektin BDO, edhe kur kemi kërkuar edhe ne një ndryshim të kësaj dinamike ose fleksibilitet në përbërjen e panelit, ata kanë thënë se tërhiqemi nga procesi dhe nuk ka pasur mundësi ndryshe.

Dardan Sejdiu theksoi se jam për me e proceduar tutje listën e kandidatëve, dhe kërkoi që deri në seancë plenare t' i dërgohen materialet e nevojshme nga procesi i intervistimit.

Memli Krasniqi, falënderoi Panelin për punën e bërë dhe theksoi se dinamika ka qenë e përcaktuar nga Partneri implementues, e jo nga Paneli. Ne e kemi marrë listën e kandidatëve, janë 12 kandidatë, por është shumë me rëndësi me pasur edhe vlerësimin final që e ka dhënë partneri implementues BDO.

Pas diskutimeve, komisioni njëzëri nxori këtë:

R e k o m a n d i m

Kuvendi të zgjedhë me votim të fshehtë 6 (gjashtë), nga 12 (dymbëdhjetë) kandidatët, për kryesues dhe drejtor të Bordit të NP KOSTT, me mandat 4 (katër) vjeçar, si vijon:

- 1.1. *Hekuran Murati;*
- 1.2. *Muzafer Shala;*
- 1.3. *Enis Berisha;*
- 1.4. *Nagip Krasniqi;*
- 1.5. *Migjen Kukaj;*
- 1.6. *Nagip Skenderi;*
- 1.7. *Shkelzen Nuza;*
- 1.8. *Sejdi Rexhepi;*
- 1.9. *Nebih Zariqi;*
- 1.10. *Naim Sahiti;*
- 1.11. *Neron Berisha, dhe*
- 1.12. *Habib Basholli.*

4. Të ndryshme **Çështjet vijuese.**

a) Kryetarja theksoi gjatë tërë javës së intervistimit që ka punuar Paneli kemi krijuar edhe shpenzime dhe komisioni duhet të marrë vendim për lejimin e shpenzimeve.

Komisioni miratoi shpenzimet e krijuara gjatë procesit të intervistimit të kandidatëve për anëtarë të bordit të KOSTT-it.

b) Kryetarja njoftoi anëtarët e komisionit se ka ardhur ftesa për mbledhjen e radhës të Plenumit Parlamentar të Komunitetit të Energjisë, që do të mbahet më 19 shkurt në Bruksel. Anëtarë të përhershëm në këtë Plenum nga komisioni jemi unë dhe z. Dardan Sejdiu, ndërsa znj. Hykmete Bajrami është anëtar alternativ. Kryetarja konfirmoi se do të marrë pjesë në

mbledhjen e Plenumit, dhe kërkoi mendimin e deputetit Dardan Sejdiu nëse mund të marrë pjesë në Plenum.

Dardan Sejdiu theksoi se tërhiqem nga pjesëmarrja në mbledhje të Plenumit për shkak të obligimeve personale.

Kryetarja kërkoi nga znj. Hykmete Bajrami nëse mundet të marrë pjesë në mbledhje të Plenumit.

Hykmete Bajrami, konfirmoi se do të marrë pjesë në mbledhje të Plenumit.

Në mbledhjen e radhës të Plenumit Parlamentar të Komunitetit të Energjisë, më 19 shkurt në Bruksel, do të marrin pjesë: Sala Berisha Shala, anëtare e përhershme e Plenumit, dhe Hykmete Bajrami, anëtare alternative e Plenumit.

c) **Kryetarja** njoftoi anëtarët e komisionit se më 12 shkurt do të vijë për vizitë z. Janez Kopaç, drejtor i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, dhe si komision do të kemi takim me z. Kopaç dhe ju ftoj të merrni pjesë në takim.

d) **Hykmete Bajrami** theksoi se kam informacion jozyrtar që Qeveria ka arritur me regjistruar operatorin e veriut për energji elektrike në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë. Nëse ka mundësi në emër të komisionit me kërkuar informata prej Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, si është regjistruar, sepse unë e di që ata asnjëherë nuk i janë referuar Kosovës sipas ligjeve dhe kushtetutës së Kosovës, si është gjetur forma e regjistrimit, nëse është regjistruar dhe janë respektuar ligjet atëherë shumë mirë. Kjo na hap rrugën neve që me diskutuar shumë ma zëshëm për anëtarësimin në ENTSO-E, si dhe me e ngritur këtë çështje edhe me z. Janez Kopac. E vetmja pengesë për mos zbatim të marrëveshjes së 2015 për energji ka qenë mos regjistrimi i operatorit në veri. Tani, nëse regjistrimi i operatorit ka ndodhur, të shohim si ka ndodhur, dhe e dyta ndoshta të organizohet një takim i veçantë i komisionit me autoritet e Brukselit, ose edhe me përfaqësues të komisioneve të tjera që me kërkuar ne zbatimin e marrëveshjes. Le të jetë kjo një kërkesë që del prej komisionit tonë.

Kryetarja potencoi se edhe unë kam informacion se është regjistruar, por nuk ka vazhduar me hapat e mëtutjeshëm, sepse pas regjistrimit duhet te licencohet në ZRRE.

Komisioni do të kërkojë informatë nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë lidhur me regjistrimin e operatorit për energji elektrike nga veriu, sipas marrëveshjes së Brukselit për energji elektrike.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti: Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Sala BERISHA SHALA